



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMANIZIMIT

Nr. 1348/1 prot.

Tiranë më 26.7.2022

Lënda: Dhënie mendimi për “Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Mbretërisë së Spanjës për krijimin e një grupi të përbashkët hetimi në fushën e luftës kundër krimit”.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 7826 prot., datë 25.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1348 prot., datë 25.07.2022, nëpërmjet së cilës kërkohet mendim mbi “Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Mbretërisë së Spanjës për krijimin e një grupi të përbashkët hetimi në fushën e luftës kundër krimit” (në vijim, “Marrëveshja”).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, Marrëveshja është në zbatim të një tjetër akti të dakordësuar nga dy vendet konkretisht, “Marrëveshjes ndërmjet Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin në Luftën Kundër Krimit” të nënshkruar në Tiranë, më datën 20.05.2009.

Sugjerimi i Zyrës së Komisionerit, mbi përmbajtjen e këtij akti, është se, në rast se nuk ka një parashikim të ngjashëm në Marrëveshjen e vitit 2009, mbas pikës 2 të nenit 2, të kësaj Marrëveshje duhet të shtohet një pikë sipas kësaj përmbajtje:

“Palët duhet të marrin masa që përpunimi i të dhënave personale të kryhet në përputhje me legjislacionet respektive për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Me përfshirjen e sugjerimit të sipërcituar, Marrëveshja vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



KOMISIONERI

Besnik Dervishi